

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE PËR GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Departamentit të Administratës Publike si njësi përgjegjëse në kuptim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave shtetërore në shërbimin civil, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;

Duke mbështetur DAP-in për zhvillimin e mëtijshëm të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë;

Duke konsideruar përparësinë e zhvillimit të mëtijshëm të reformës së administratës publike si një prioritet kyç për hapjen e negociatave të pranimit në Bashkimin Evropian;

Vlerëson veprimtarinë e Departamentit të Administratës Publike për vitin 2022 në drejtim të:

Unifikimit të zbatimit të ligjit në shërbimin civil.

Ngritjes së kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).

Ofrimit të shërbimeve online ose rreth 95% të të gjitha shërbimeve publike.

Zbatimit të rekomandimeve të lëna nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Bashkëpunimit dhe përfshirjes në projektet “IPA II European Union Integration Facility 2020 “Ngritja e kapaciteteve për nëpunësit civilë të administratës publike, përfshirë trajnimet/praktikat në administratat e vendeve anëtare të BE-së dhe skemën e bursave (“qelizat e reja”)” dhe “Projekti Anketa e ReSPA për nëpunësit publikë në Ballkanin Perëndimor”.

Organizimit, marrjes pjesë brenda dhe jashtë vendit në aktivitete të ndryshme.

Bashkëpunimit me KMSHC duke nisur punën për hartimin e një drafti të parë të projektligjit për ndryshime në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Rekrutimit në shërbimin civil në lidhje me pozicionet e lira, procedurat e rekrutimit, aplikimet për procedurat e konkurrimit, plotësimin e pozicioneve vakante në shërbimin civil, lirimet në shërbimin civil.

Administrimit të formularëve të vetëdeklarimit të plotësuar nga subjektet vetëdeklaruese në zbatim të ligjit nr. 138/2015.

Procese të ristrukturimit dhe krijimit të institucioneve të reja.

Realizimit të rritjes së pagës minimale nga 30.000 lekë në muaj në 32.000 lekë në muaj me VKM-në nr. 158, datë 12.3.2022.

Realizimit të rritjes së pagës minimale nga 32.000 lekë në muaj në 34.000 në muaj me VKM-në nr. 604, datë 14.9.2022.

Kuvendi kërkon që Departamenti i Administratës Publike për vitin 2023 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të realizojë procedurat e konkurrimit për pozicionet e nivelit ekzekutiv në përputhje me parimet e përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil, duke i ndërtuar me eficiencë grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me qëllim garantimin e një procesi përzgjedhës transparent, të drejtë dhe objektiv të nëpunësve civilë, si dhe kryerjen në mënyrë sa më efektive të procedurave të rekrutimit.

2. Duhet të vijojë punën e tij drejt rritjes së cilësisë së trupës së nëpunësve civilë të rekrutuar nëpërmjet ndërveprimit me qytetarët, me qëllim rritjen e numrit të konkurrentëve, duke publikuar në portalin “online” të aplikimit informacionet që shërbejnë për të kuptuar procedurat e rekrutimit dhe për t’i ndërgjegjësuar ata për rëndësinë e rritjes së nivelit të pjesëmarrjes në këto procedura.

3. Departamenti i Administratës Publike duhet të tregojë nivel më të lartë bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore, me qëllim raportimin e pozicioneve të lira për të siguruar rritjen e efektivitetit në realizimin e procedurave të rekrutimit në përputhje me dispozitat ligjore.

4. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike duhet të krijojë infrastrukturën për ofrimin e kurseve online; duhet të krijohet cikli i trajnimit për menaxhimin e cilësisë; duhet të merren masa lidhur me përmirësimin e aftësisë administrative të nëpunësve civilë të nivelit vendor.

5. Të angazhohet në automatizimin e sistemit të listëpagesave nëpërmjet sistemit informatik të burimeve njerëzore në të gjithë sektorin publik.

6. Të hartojë Strategjinë e re Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike për vitin 2023 e në vijim.

7. Në përcjelljen e raportit në Kuvend t’u referohet rregullave të përcaktuara në vendimin e Kuvendit nr. 134/2018

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 15.6.2023.